



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

Numri i lëndës: 2024:138949

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05708487

P.nr.110/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRI-Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me procesmbajtësen-praktikanten Diana Fejza në çështjen penale kundër të pandehurve O.Sh me vendbanim në fshatin ..., Komuna e Vushtrrisë dhe D.B me vendbanim në Vushtri rruga " ..." nr.14 për shkak të veprës penale *Sulmi* nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorit te shtetit PP.II.nr.808/24 të dt. 15.05.2024, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, më datë 20.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorit te shtetit PP.II.nr.808/2024 të dt. 15.05.2024, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I PANDEHURI I PARË: O.Sh, nga i ati S, e ëma V, e gjinisë M, i lindur me ..., në Mitrovicë, me vendbanim në fshatin ..., Komuna e Vushtrrisë, me numër personal ..., i pa martuar, i gjendjes së mirë ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II PANDEHURI I DYTË: D.B, nga i ati I, e ëma S, e gjinisë L, i lindur me ..., në Prishtinë, me vendbanim në Vushtri, rruga "...", nr... me numër personal ..., i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, i punësuar si kamerier shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

SEPSE: Me datë 22 mars 2024, rreth orës 15:30h, në rrugën ..., në Vushtri saktësisht përballë marketit E..., të pandehurit së bashku me të miturin ..., me dashje kanë përdorë forcën ndaj të personit tjetër, të dëmtuarave A.D dhe J.H, në atë mënyrë që sapo takohen në vendin e lartpërmendur, të pandehurit dalin nga vetura e tyre dhe fillojnë ti sulmojnë fizikisht të dëmtuarit me grushte e shqelma nëpër pjesë të ndryshme të trupit.

-Me këtë kanë kryer veprën penale: *Sulmi* nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 38, 43, 69, 70 dhe nenit 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, si dhe bazuar ne nenet 364, 449, 452, 462, 493, 495 të KPP-së:

G J Y K O N

Të pandehurit të parë O.Sh i shqipton dënimi me gjobë në shumën prej **200€** (dyqind euro), i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të pandehurit të dytë D.B i shqipton dënimi me gjobë në shumën prej **200€** (dyqind euro), i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se i akuzuari refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, ashtu që çdo 20€ (njëzet euro) e dënimit me gjobë, është e barasvlershme me nga 1(një) ditë burgim.

DETYROHEN të pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 30€ (tridhjetë euro), dhe ne emër te taksës për kompensimin e viktimave te krimit te paguaj shumen prej 20€ (njëzet euro).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.808/24 të dt. 15.05.2024, kundër të pandehurve O.Sh me vendbanim në fshatin ..., Komuna e Vushtrrisë dhe D.B me vendbanim në Vushtri rruga " ..." nr.14 për shkak të veprës penale *Sulmi* nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së,

Gjykatës i është kërkuar që kundër të pandehurit të jep Urdhërin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë se shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se të pandehurve vërtetë e kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale *Sulmi* nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me të cilën akuzohen të pandehurit, " *Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit* " që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraparak të çështjes e konform nenit 493 dhe 494 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform dispozitave nga neni 495 par.1 të KPPK-së, ashtu që mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: raporti fillestar i incidentit, me numër të rastit 2024-BD-257, i datës 22.03.2024, raporti i oficerit me numër të rastit 2024-BD-257 i datës 22.03.2024, procesverbal i marrjes në pyetje për të ankuesit A.D, i datës 22.03.2024;procesverbal i marrjes në pyetje për të ankuesit J.H, i datë 22.03.2024;procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin O.Sh i datës 22.03.2024; procesverbal i marrjes në pyetje për

të dyshuarin ... i datës 22.03.2024;procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin D.B i datës 22.03.2024;informacionet për të kaluarën kriminale për të dyshuarin ..., nga Policia e Kosovës; informacionet për të kaluarën kriminale për të dyshuarin O.Sh, nga Policia e Kosovës si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme me të cilat vërtetohet se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elemente të veprës penale *Sulmi* nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për këtë edhe i shqipton urdhërin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata morri parasysh rrethanat si: shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, si dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Gjykata çmon se dënimi me gjobë i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe se është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale së të pandehurit dhe me intensitetin e rrezikimit vlerës së mbrojtur. Së këndejmi me praninë e të gjitha këtyre rrethanave nuk ka pasur vend që të pandehurit ti'u shqiptohet dënim më i butë ose me i rëndë.

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë të kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsoi dënimin kundër tij.

Vendimin mbi kërkesën pasurore juridike gjykata e mori në bazë të nenit 462 par.2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushall gjykata e mori në kuptim nenit 449 par.2 nen paragrafi 2.6 lidhur me par. 1 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë në kuptim të nenit 364 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal

P.nr.110/24, të datës 20.05.2024

Procesmbajtëse-praktikantja
Diana Fejza

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.